



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DURRËS
DREJTORIA LIGJORE**

PROJEKTVENDIM

NR.____, DATË ____/____/202__

**PËR
PËRDORIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NGA GRANTI I BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR VITIN 2025**

Në zbatim të ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.1, datë 11.07.2025, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", si edhe në vijim të shkresës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 Prot., datë 19.12.2025, e cila përcjell vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, që ka përfituar bashkia Durrës është 5,024,923.98 lekë, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe Komuniteteve Fetare, kryetari i bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe,

TË VENDOSË:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5,024,923.98 (pesëmilion e njëzet e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë të përfituar nga Granti i Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025 për: "Blerjen e mjeteve didaktike për pajisjen e institucioneve të arsimit parashkollor (kopshteve) në territorin e Bashkisë Durrës.
2. Ky fond do të financohet në vlerën 2,247,191.01 (dymilion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e një qind e nëntëdhjetë e një pikë zero një) lekë nga buxheti i shtetit dhe në vlerën 2,777,732.97 (dymilion e shtatë qind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë është financim i huaj.

3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare , Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij projektvendimi

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.


DREJTORIA E BUXHETIT

Drejtor
Valbona Qirjako




DREJTORIA EKONOMIKE

Drejtor
Ina Ferra



DREJTORIA LIGJORE

Drejtor
Alheida Broshi




**DREJTORIA E AKRS
KOM. FETARE**

Drejtor
Migena Muhaj



KRYETAR

Emiriana Sako





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

RELACION

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË PËRFITUAR NGA GRANTI I BAZUAR NË
PERFORMANCË PËR BASHKITË PËR VITIN 2025**

Në zbatim të ligjit nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Granti i Performancës për bashkitë", udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.1, datë 11.07.2025, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025", si edhe në vijim të shkresës së Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 Prot., datë 19.12.2025, e cila përcjell vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve në kuadër të GBP 2025, Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, që ka përfituar bashkia Durrës është **5,024,923.98 lekë**. Ky grant do të financohet në masën 44.7% ose 2,247,191.01 lekë nga buxheti i shtetit dhe 55.3% ose 2,777,732.97 lekë janë financim i huaj.

Pjesa e grantit që financohet nga buxheti i shtetit prej 2,247,191 lekë është alokuar në Thesar, në formën e transfertës së pakushtëzuar, në dhjetor 2025, kurse pjesa e grantit me burim financimi nga financim i huaj do të alokohet pasi të merret Vendimi i Këshillit Bashkiak për destinacionin e përdorimit të tij.

Sic përcaktohet në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor nr.1, datë 11.07.2025, bashkitë kanë pavarësi të plotë për përdorimin e këtij fondi, me përjashtim të shpenzimeve për personelin dhe shpërblime. Ministria e Financave pas marrjes së Vendimit të Këshillit Bashkiak dhe kërkesës për celje fondi bëjnë të mundur celjen e kodit të produktit/projektit në SIFQ (Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë) me qëllim më pas transferimin e fondit. Gjendja e fondit të prokuruar dhe të papërdorur nga Bashkitë në fund të vitit buxhetor trashëgohet në vitin buxhetor pasardhës dhe përdoret për të njëjtat produkte/projekte për të cilin është prokuruar. Gjendja e fondit të ngelur tepriçë nga procesi i prokurimit përdoret nga Bashkitë për qëllime të tjera që ato gjykojnë dhe vendosin me vendim të Këshillit Bashkiak.

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, në Ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar me ligjin 48/2018, neni 28, pika 4, të këtij ligji, i cili përcakton se bashkitë janë përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe pajisjen e institucioneve të arsimit parashkollor me mjete didaktike dhe kushte të përshtatshme për zhvillimin e procesit edukativ propozojmë që ku fond të përdoret për pajisjen e kopshteve me mjete didaktike.

Qëllimi kryesor i përdorimit të fondit është përmirësimi i cilësisë së shërbimit të arsimit parashkollor në Bashkinë Durrës, nëpërmjet pajisjes së institucioneve arsimore me mjete didaktike të përshtatshme, në përputhje me standardet e arsimit parauniversitar. Kjo ndërhyrje synon të krijojë

kushte më të mira për zhvillimin e procesit edukativ, të mbështesë zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve dhe të reduktojë diferencat në nivel pajisjeje midis institucioneve të ndryshme parashkollore në territorin e bashkisë.

Në përmjet këtij fondi do të bëhet blerje e materialeve dhe mjeteve didaktike, si dhe pajisja e klasave të kopshteve me elementë edukativë në përputhje me standardet kombëtare. Lista e mjeteve didaktike do të hartohet nga struktura përgjegjëse për arsimin në bashki, në bashkëpunim me drejtuesit e institucioneve parashkollore dhe strukturat arsimore përkatëse, duke u bazuar në nevojat reale të çdo institucioni.

Përdorimi i këtij fondi pritet të sjellë përmirësim të ndjeshëm të cilësisë së procesit edukativ në arsimin parashkollor, rritje të sigurisë dhe komoditetit për fëmijët, si dhe përmbushje më të plotë të standardeve të arsimit si dhe përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së mjediseve edukative në institucionet e arsimit parashkollor, veçanërisht për sa i përket mungesës ose amortizimit të mjeteve didaktike dhe nevojës për materiale bashkëkohore që mbështesin zhvillimin kognitiv, social dhe emocional të fëmijëve. Në këtë kuadër, përdorimi i fondit të grantit të performancës për pajisjen e kopshteve me mjete didaktike konsiderohet një ndërhyrje konkrete, në përputhje me detyrimet ligjore të bashkisë dhe me prioritetet e përcaktuara në dokumentet strategjike të saj.

Kjo nismë do t'u shërbejë 54 kopshteve në territorin e Bashkisë Durrës dhe 3400 fëmijëve që frekuentojnë arsimin parashkollor.

Për sa më sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë :

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 5,024,923.98 (pesëmilion e njëzet e katër mijë e nëntëqind e njëzet e tre pikë nëntëdhjetë e tetë) lekë të përfituar nga Granti i Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025 për: "Blerjen e mjeteve didaktike për pajisjen e institucioneve të arsimit parashkollor (kopshteve) në territorin e Bashkisë Durrës.
2. Ky fond do të financohet në vlerën 2,247,191.01 (dymilion e dyqind e dyzet e shtatë mijë e një qind e nëntëdhjetë e një pikë zero një) lekë nga buxheti i shtetit dhe në vlerën 2,777,732.97 (dymilion e shtatë qind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy pikë nëntëdhjetë e shtatë) lekë është financim i huaj.
3. Ngarkohen Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare , Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij projektvendimi

Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sportit dhe komuniteteve fetare

Drejtor

Migena Muhja

Drejtoria e Buxhetit

Drejtor

Valbona Qiriako